



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.3243/2 prot.,

Datë 03.01.2024

**FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT TË OPERATORIT EKONOMIK
ANKIMUES DHE PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN/SKUALIFIKIMIN E
OFERTUESVE TË TJERË**

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” SHPK në procedurën e prokurimit “*E Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-82208-10-04-2023, me objekt “Blerje materiale kancelarie për Bashkinë Fushë-Arrëz”, me fond limit 1,384,166 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 19-12-2023, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fushë-Arrëz.

Të mbetet i skualifikuar operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK

Ankimues: Operatori ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” SHPK *me Nipt. L91418502J dhe adresë: Autostrada Tiranë-Durrës km. i fundit, zona kadastrale nr.8517, Durrës.*

Subjekt i interesuar Operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK me Nipt J62426002Q. *Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, Km. 8, Kashar, Tiranë.*

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Fushë-Arrëz
Adresa: Qendër Fushë-Arrëz.

Në datën 29.12.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është protokolluar ankesa me nr. 3243 prot., e operatorit ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” SHPK, për procedurën e prokurimit “*E Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-82208-10-04-2023, me objekt “Blerje materiale kancelarie

për Bashkinë Fushë-Arrëz”, me fond limit 1,384,166 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 19-12-2023, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fushë-Arrëz.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” SHPK, nga procedura e prokurimit të sipërcituar, si dhe pretendime që të mbetet i skualifikuar operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b”, “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;
c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” SHPK, kundërshtuar në ankesën me nr.3243 Prot., datë 29.12.2023.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

- **Arsyet e skualifikimit:**

O.E "LIBRARI DYRRAHU" nuk ploteson kriteret sipas DST-se, si mëposhte:

Vertetimi i taksave Nr. 263 Regj. DTTV, datë 11.04.2023, rezulton i paqartë lidhur me likuidimin e detyrimeve të taksave, pra nuk është i përcaktuar qartë viti i shlyrjes së detyrimeve, të kërkuar në DST sipas pikës 2.2, “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, pika 2.2.2.

Mungon paraqitja e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, të kërkuar në DST sipas pikës 2, “Kriterët e veçanta të kualifikimit”, gërma a, shtojca 8.

Mungon licensimi për furnizime të këtij lloji ose ekuivalente, të kërkuar në DST sipas pikës 2.3, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.1.

- Pretendime që OE. “InfoSoft Office” SHPK, të qëndrojë i skualifikuar.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 03.01.2024

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri